REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA GJYQËSORE

Nr. 996 Prot. Tiranë,më 15.04.2003

L ë n d a : *Mbi zbatimin e Urdhrit nr. 169 datë 29.08.2002 " Për gatishmërinë dhe informimin në Prokurori.*

**PROKURORISË SË APELIT**

Sikundër jeni në dijeni, me synim organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë në Prokurori dhe garantimin e informimin në kohë në prokuroritë e të gjitha niveleve për veprat e rënda kriminale e zgjidhjet ligjore të kërkuara nga prokurorët në gjykim, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin nr. 169 datë 29.09.2.002, i cili ka hyrë në fuqi në datë 10.092002.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, prokuroritë përgjithësisht kanë reaguar me korrektësi, por megjithatë sidomos nga Prokuroritë e Apeleve janë vërejtur edhe mangësi duke mosevidentuar të dhëna të rëndësishme që lidhen me gjykimet ne apel.

Me qëllim, për të evituar mangësitë e vërejtura si dhe për të siguruar të dhëna sa më të plota, në informacionet e prokurorive të apelit' duhet të pasqyrohen edhe këta tregues :

- Nr. i procedimit, viti dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor.
- Nr. Vendimit gjyqësor dhe data.

- Dispozitivi i vendimit lidhur me çka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë.

- Kush ka ushtruar apelim dhe shkaqet.

- Emri i prokurorit që ka marrë pjesë në gjykimin në apel dhe kërkesa e tij.

- Shkaku i heqjes dorë nga apeli apo kërkesa për zbutjen e pozitës së të pandehurit.

- Nëse është analizuar paraprakisht çështja me prokurorin e shkallës së parë, emri i prokurorit që ka marrë pjesë në shkallë të parë dhe mendimi i tij.

- Mendimi i prokurorisë së apelit nëse do të ushtrohet rekurs ose jo, dhe argumenti nëse gjykohet se nuk ka vend për të ushtruar rekurs.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU